



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**



**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 08.08.2023  
Ref. KM-299/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**VENDIM**

**Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim**

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve –ESTIUOIL i prodhuesit “Exclusivas Sarabia S.A”, Spanjë nga përfaqësuesi i saj “EcoTech-Pest Control” SH.P.K, Suharekë.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Insekticid, Akaricid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Vaj mineral i parafinuar  
Numri CAS 8042-47-5.....790 g/l

**4. PËRDORIMI:**

ESTIUOIL është një produkt me përqendrim të lartë të vajit mineral parafinik. ESTIUOIL ka një fuqi të lartë insekticidi për kontrollin e të gjitha llojeve të insekteve dhe merimangave në shkallë të lartë në fazën e qetësisë- dimërore, të cilën ajo vepron përmes kontaktit që shtrihet mbi sipërfaqen e insektit duke parandaluar frymëmarrjen e tij. Gjithashtu bllokoi zhvillimin e vezëve të insekteve dhe merimangat për të parandaluar shkëmbimin e gazit. Depërtimi i vajit në insekt ndikon gjithashtu në procese të ndryshme fiziologjike.

Doza dhe metoda e përdorimit:

Kryeni trajtimin (1 në vit) para vejetacionit.

**Agrume** (portokall, limon, mandarinë, grejpfrut), kundër marimangave (*Panonychus citri*, *Eutetranychus banki*, *Tetranychus urticae*) dhe cochineals (*Aonidiella aurantii*, *Aspidiotus nerii*, *Lepidosaphes spp*, *Parlatoria pergandii*).Përdorni në doze: 1-1,5L/100litra ujë, shpërndarë me 1000-2000 lit/ujë/ha.

**Drufrutore** ( mollë, dardhë kumbull etj ), kundër dëmtueseve (*Quadraspidiotus pemiciosus*),me doze; 0.75-1lit/100 lit/ujë duke shpenzuar 500-100 lit ujë për hektar.

**Bërthamoret:** (pjeshkë nektarin, kajsia, kumbull, qershia) kundër dëmtueseve (*Quadraspidiotus pemiciosus*, *Pseudaulacaspis pentagona*). Përdoreni në një dozë prej 0,75-1lit/100lit/ujë, shpërndarë me 500-1500 L/ha ujë.

**Pregatitja:** Produktin tundeni para tretjes si dhe gjatë spërkatjes duhet vazhdimisht të përzihet me pjesën e posaçme të atomizerit.

#### 5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

100ml,250ml,500ml,1L,5L,10L,25L,600L,800L.

#### 6.VËREJTJE:

Produkti nuk mund të përzihet me produkte të bazuara në sqfur, polysulphides, captan ose folpet.

Mos e aplikoni produktin para se të kalojnë të paktën 40 ditë nga trajtimi me sqfur,polisoffuri,captano ose folpet, por përzihet me bazë bakri.

**FITOTOKSICITETI:** Mos kryeni trajtime në ditë të nxehta dhe të thata.

#### 7. KARENCA:

Nuk aplikohet



#### 8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:

GHS08:i rrezikshëm për shëndetin

#### 9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

#### 11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



#### Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.